

Prishtinë: 27/04/2006  
**ERO/CPD\_D\_01\_04\_06**

**Për** : Z. Tomë Krasniqi

**Nga** : Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve

**Lënda** : Përgjigje në Ankesën me Nr 1/4 2006 të datës 13.04.2006

I nderuari Z. Krasniqi

Në bazë të kompetencave të dhëna prej Nenit 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në një sesion të mbajtur me 17 Janar 2006 ka miratuar Rregullën mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka pranuar me datë 13.04.2006 ankesën e Z. Tomë Krasniqit i cili ushtron ankesë për shkak të heshtjes administrative në administratën e shërbimeve publike të KEK-ut për arsye se Divizioni i Furnizimit, Sektori i Shitjes në Prishtinë nuk i është përgjigjur në ankesën e tij shkrimore me Nr 70/2006 datë 02.03.2006, kërkesa e Z Tomë Krasniqi e parashtruar në ankesën me Nr 70/2006 ka qenë që të lirohet nga parapagimi për RTK-në dhe rivendosjen e gjendjes financiar në zero (0) ashtu si ka qenë para datës 31.10.2003.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në ZRRE ka regjistruar ankesën me Nr 1/4 2006, të cilën e ka shqyrtuar dhe analizuar në hollësi.

Kryesuesi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në bazë të kompetencave të dhëna sipas nenit 14.3 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë në emër të ZRRE-së nxjerr këtë:

#### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e regjistruar me Nr 1/4 2006 në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 13.04.2006.

#### Arsyetim

Në bazë të nenit 8.3 të Rregullës për Zgjidhjen e Kontesteve në Sektorin e Energjisë afati përfundimtar për shqyrtim dhe hulumtim të ankesës, nga ana e furnizuesit nuk do të jetë më e gjatë se shtatëdhjetepesë (75) ditë kalendarik që prej datës së pranimit dhe regjistrimit të ankesës, andaj ky afat kohor nuk ka kaluar dhe furnizuesi nuk mund të konsiderohet se ka bërë heshtje administrative. Me datë 24.04.2006 Divizioni i Furnizimit i pergjigjet ankuesit në ankesën me Nr 70/2006 të cilën pergjigje po të njëjten datë ankuesi e ka sjellur në DMK.

Në bazë të urdhëresës administrative Nr 2003/12 të datës 3 qeshor 2003, duke u thirrur në Nenin 2.1 të kësaj Urdhërese Administrative çdo shtëpi, biznes, ndërmarrje apo institucion tjetër në Kosovë është i obliguar sipas ligjit që ta paguajë këtë pagesë.

Në bazë të nenit 2.2 të Urdhëresës Administrative Nr 2003/12 RTK ka autorizim që të lidhë marrëveshje me ndonjë organiza të cilën ajo e konsideron të përshtatshme, duke përfshirë Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës dhe kompaninë e Postës dhe të Telekomunikacionit të Kosovës, për të ofruar shërbime të nevojshme lidhur me arkëtimin e kësaj pagese. Një organizat e tillë do të ketë autorizim për të arkëtuar pagesën nga familjet, bizneset apo institucionet e tjera.

Të liruar nga kjo pagesë sipas nenit 5.1 të kësaj Urdhërese Administrative janë vetëm familjet që janë përfshirë në listën e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale për asistencë sociale.

Pasi që ju nuk i plotësoni kushtet e nenit 5.1 të Urdhëresës Administrative Nr 2003/12 ankesa e juaj është refuzuar

**Udhëzim juridike:** Kundër këtij vendimi konsumatori mund të apelojë në Bordin e ZRRE-së brenda afatit katermbëdhjetë (14) ditëve kalendarike nga dita e njoftimit të konsumatorit.

Vendimi i dërgohet :  
Z. Tomë Krasniqi

Me respekt  
Azem Kastrati  
Udhëheqës i DMK-së



Kopje:  
Administratës së ZRRE-së  
Departamentit Ligjor dhe të Licensimit